



**REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E DOGANAVE**

**RAPORT PËR PUNËN E DREJTORIS SË
DOGANËS NË VITIN 2006**

SHKUP ,DHJETOR 2006

Raporti ka për qëllim para përfundimit të këtij viti ta informon opinionin për punën e Drejtorisë së Doganës të RM në 2006, veçanërisht duke u përqëndruar në qëllimet dhe politiken e kësaj udhëheqësie. Në raportin vjetor më detalisht do të elaborohet puna e Drejtorisë së Doganave. Udhëheqësia është e vetëdijshme se duhet të vazhdon me zhvillimin dhe zotësin e Drejtorisë së Doganave që të mund t'u përgjigjet sfidave dhe detyrave të cilat qëndrojnë para saj, ndërsa ato janë:

- Përsheptimi i kanalit të mallrave dhe shërbimeve, para së gjithash nëpërmjet aplikimit të udhëheqjes integrale doganore .
- Përparimi i biznesit ambientit, nëpërmjet sigurimit dhe procedurave të qarta dhe transparente.
- Mbrojtja e shoqërisë, nëpërmjet ndalimit të importimit jolegal, transit në dhe nga RM të narkotikëve , armëve, dhe larjen e parave.
- Arkëtimi i plotë dhe i rregullt i të dhënave importuese, në mënyrë të drejtë dhe korrekte.
- Ndërtim të sistemit për kontroll dhe mbrojtjen e kufijve dhe ekonomisë në RM, standardeve kompakte dhe kërkesave të UE.

Realizimi i këtyre detyrave do të varet nga sigurimi i tre parakushteve kryesore:

- refuzimi i korrupsionit
- përparimi i kapacitetit institucional
- zhvillimi dinamik i sistemit informativ

Në fillimin e vitit 2007 Drejtoria e Doganës do të promovon plan aksionar të aktiviteteve të përqëndruara drejt realizimit të qëllimeve strategjike .

Realizimi i disa pjesëve të këtyre aktiviteteve filloi në këtë vit.

1. Në suaza të masave për refuzimin e korrupsionit janë të realizuara apo janë në fazë të realizimit aktivitetet në vijim:
 - Numri i inspektorëve në sektorin për përgjegjësi profesionale është rritur prej 6 në 13 persona.
 - Janë duke u bërë hetime dhe kontroll të brendshme
 - Janë kryer 66 hetime të brendshme për sjelljen jopërkatese dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare të doganierit.
 - Janë të iniciuara një numër i madh i procedurës disiplinore dhe masave ,në të cilën edhe largim nga puna. Me sjelljen e masave disiplinore bëhen të njohura të gjitha llojet e organizimit.
 - Janë zbardhur më shumë se 3000 raste me vjet të tëra të mospagesës apo kërkesave të pasqaruara në emër të dhënave importuese prej më shumë se 700 firma, nga të cilët më shumë se gjysma janë likuiduar apo janë në procedurë falimentimi. Shuma e plotë të mospagesës të dhënave importuese bashkë me kamatën arin më pak 2 miliard denar . Në rrjedhë janë aktivitetet për vërtetim të plotë të kërkesave ,përgjegjësia ,si dhe arkëtimi.
 - Është vërtetuar humbja e 340 tonë duhan i prerë aromatik i përgatitur për mbushjen e cigareve ,pronë e RM .lënda iu është dorëzuar organit hetues të MPB.
 - Në rrjedhë është regjistrimi i jashtëzakonshëm i mallit të konfiskuar me qëllim të vërtetohet se gjendja faktike a përputhet me evidentimin. Kjo bëhet nga arsyeja se deri tani nuk është bërë regjistrim,ka të dhëna se akoma ekziston mall i konfiskuar nga periudha para vitit 1990 dhe një pjesë mungon apo nuk dihet se ku është.
 - Është përgatitur strategjia për largimin nga korrupsioni

- Është përgatitur listë prej mbi 200 akte ligjore dhe nënligjore me të cilën është rregulluar puna doganore . Kanë filluar aktivitetet për largimin e tyre nga ngarkimi i panevojshëm administrativ dhe financiar të sektorit privat dhe eliminimin të panevojshëm të drejtës diskrecionale të Drejtorisë së Doganës të cilat japin hapësirë për korrupsion .
- Është përgatitur kodifikimi për sjelljen e doganierëve
- Në rrjedhë janë aktivitetet për rregullimin e video kamerave ekzistuese në kalimin kufitar,vendosja e video kamerave në kalime tjera kufitare dhe në degët doganore,sigurim i video kontrollit në kohë reale dhe sjelljen e akteve interne me të cilin do të rregullohet kjo lëmi.
- Janë iniciuar aktivitetet për sjelljen e procedurave interne për punën e njësive organizative të Drejtorisë së Doganave.
- Është rindërtuar puna e GPS mjeteve për përcjelljen e ekipit mobil të Drejtorisë së Doganës.
- Në rrjedhë janë aktivitetet për vendosjen e kutive dhe vegla për shënimin e vendeve ku nëpunësit doganor kanë kontakte me opinionin (kalimi kufitar terminal etj)për shënimin dhe dorëzimin e ankesave dhe vendosja e rregullave për marrje,kontrollimi dhe analizimi i ankesave nga aspekti me kë kanë të bëjnë,në cilat pjesë organizativ dhe për cilën përmbajtje .
- Punohet për sjelljen e numrave të ri të identifikimit të nëpunësve doganor.
- Po shqyrtohet mundësia për sjelljen e vërtetimit vjetor të gjendjes pasurore të doganierëve dhe përcjelljen në suaza të vetë Drejtorisë së Doganës.
- Po përparon lajmërimi javor dhe bisedimet kohore për vëllimin e punëve të kryera nga ana e nëpunësve doganor dhe degëve doganore(vetura të kontrolluara,janë zbardhur kundërvajtje doganore dhe vepra penale)
- Janë sjell raportet javore për punën e ekipeve mobile.
- Kanë filluar analizat të raporteve për strukturat e ankesave të parashtruara në numrin e telefonit 197 (ku më shumë ankohen personat dhe pjesët organizative në të cilin janë drejtuar ankesat);
- Po riprovohen vendet ku janë vendosur lajmërimet për shfrytëzimin e numrit të tel 197 (në hyrje apo dalje të RM,dhe terminal)personat e interesuar a mund në kohë ti shohin,të huajt a e kuptojnë apo është e mjaftueshme vetëm numri 197për të lajmëruar,çka nëse paraqitjet nuk janë në gjuhën angleze,por në gjuhën gjermane,greke,shqipe,franceze,apo ndonjë gjuhë tjetër).
- Po përgatitet rregullore për punë me 197(si incizohen dhe shkruhen porositë e pranuar,si kontrollohet distribuhimi i porosive të pranuar).
- Punohet për sjelljen e analizave në porositë e pranuar(për cilët persona bëhet fjalë ,cilat pjesë organizative,për cilën problematikë)dhe informim i rregullt i opinionit dhe të punësuarve në Drejtorinë e Doganës për të dhënat statistikore për paraqitjet në 197.
- Po futet përcjellja dinamike e vëllimit të punëve të kryera nga ana e shërbimeve doganoren në kalimin kufitar dhe dega doganore.
- Kanë filluar aktivitetet për rregullimin e së drejtës për shpërblim të doganierëve,largimin nga korrupsioni dhe zvogëlimin e barrierave administrative që do të jenë të pranuar dhe praktikisht do të zbatohen.

2. Në drejtim të përparimit të kapacitetit institucional të Drejtorisë së Doganës në vitin 2006 janë realizuar dhe janë bërë aktivitetet në vijim:
 - Janë mbajtur 135 trajnime,seminare,dhe prezantime. Në këto trajnime kanë marrë pjesë gjithsejtë 1479 pjesëmarrës nga Drejtoria e Doganës.
 - Janë organizuar 5 prezantime nga ana e Drejtorisë së Doganës për njohjen e subjekteve të jashtëm me procedura të caktuara sipas ligjit të ri Doganor në të cilën kanë marrë pjesë gjithsejtë 175 pjesëmarrës nga kompani dhe ekspedues të ndryshëm;
 - Është arritur bashkëpunim i suksesshëm me organizata dhe institucione tjera në dhe jashtë vendit ,siç janë:shërbimet doganore të Republikës së Francës,Mbretërisë Holandeze,Ambasada në SHBA,Këshilli Britanik,sektori për punët kufitare të Ministrisë së Punëve të Brendshme,zyra për ozon pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe planifikim hapësinor.
 - Është përgatitur plan për trajnime e të punësuarve në vitin 2007 për ripërtrirje dhe zgjerimin e diturive;
 - Në përgatitje është një marrëveshje e re kolektive.
 - Është përgatitur një dekretligji i ri për uniformat e nëpunësve doganor.
 - Janë realizuar dhe organizohet zbatimi i trajnimeve për fitimin e një udhëheqje të shkathtë.
 - Në rrjedhë është procedura për angazhimin e agjencisë për evallim dhe anketa të kuadrit udhëheqës në Drejtorin e Doganave
 - Nëpërmjet Ministrisë së Financave është shpallur tender për angazhimin e ekspertëve të huaj doganor,të cilët do të punojnë për përparimin e kapacitetit të Drejtorisë së Doganave në lëmin për kundërzbulim,zbulimin dhe ndalimin të tregtisë jolegale,krimin ekonomik,dhe terrorizmin.
 - Në përputhje me prioritetet më të larta të euro integritimeve,kanë filluar aktivitetet për përkufizimin dhe vendosjen e sistemit të ri informatikë komunikative teknologjike. Me qëllim që përshpejtimi i punëve dhe krijimi i kushteve teknike për plotësimin e standardeve informative dhe komunikative evropiane dhe lidhjen drejt sistemeve ekzistuese doganore të UE,kanë filluar apo janë në përfundim realizimi i shumë projekteve ,siç janë sistem i ri transit për ndrzshimin e porosive elektronike,aplikimi për rritjen e transparencës gjatë shpërndarjes së kuotës.
 - Në rrjedhë është përgatitja e projektit për angazhimin e eksperteve për përpunimin e plotë të studimeve diagnostiko të sistemit informativ të Drejtorisë së Doganës dhe përgatitja detale e dokumenteve për mbulimin e plotë aplikativ të Drejtorisë së Doganave.
3. Në drejtim të lehtësimit të transportit,tregtisë dhe përmisimin e biznes ambientit janë realizuar aktivitetet në vijim:
 - Është organizuar trajnim dhe janë dhënë 550 licenca personave si përfaqësues të doganave,ndërsa 220 kompanive iu është dhënë leje për punët e kryera në përfaqësimin e doganave.
 - Janë formuar 5 shërbime regjionale për mbikëqyrjen e lejimit të pronësisë. Këto shërbime janë kompetente për kontakt direkt me lejimin e pronësisë dhe aktivitetet e veta të para që i ka në pjesën e importit të fisnikëruar. Në vitin 2006 janë dhënë 230 leje për import për fisnikërimin e sistemit të pagesës së pezulluar dhe 15 leje me sistem për kthimin e doganës. Në rrjedhë janë aktivitetet për tejkalimin e problemeve të identifikuar gjatë zbatimit praktik të dispozitave të reja në këtë fushë.

- Në bazë të dispozitave të reja doganore është dhënë leje për 58 depo doganore. Në rrjedhë janë aktivitetet për kontroll për punën e tyre.
- Në përputhje me dispozitat e reja doganore në pjesën e transportit, sipas të cilave të ashtuquajturit dërgues dhe pranues të autorizuar të cilët do të mund ta fillojnë, gjegjësisht ta përfundojnë procedurën transportuese drejtpërdrejt nga hapësirat e veta me evitim të duhur të mjeteve transportuese të depërtuara në të ashtuquajturit terminale doganore, janë dhënë edhe 6 leje për pranues i autorizuar në procedurë transportuese dhe një leje për përdorimin e plumbave të veçanta.
- Janë rindërtuar dhe intensifikuar aktivitetet për integrimin e udhëheqjes doganore dhe futjes të sistemit një sportel.
- Në përputhje me përfundimet e Qeverisë së RM, në rrjedhë janë përgatitjet për marrjen e udhëheqjes me terminalat shtetërore dhe objektet në kalimin kufitar nga NP për ekonomizimin me banesat dhe rrethimin hapësinor;
- Po përgatitet strategji për mundësimin e doganimit në terminalat shtetërore në kalimet kufitare (të cilat tani nuk janë në funksion) dhe doganim lokal me çka do të zvogëlohet transportimi i mallrave të padoganuara nëpër shtetin dhe do të zvogëlohen shpenzimet e kompanive, si dhe ndërtimi i terminalit në suaza të zonës së lirë ekonomike në Bunarxhik;
- Në rrjedhë është hulumtimi i të dhënave jo tarifore dhe lartësia e tyre, si dhe shpenzimet për qëndrim në terminalat (peshore, vendosjen, ngarkim, shkarkim).
- Ka filluar bashkëpunimi me transportuesit;
- Është ndërtuar komiteti për punën ekspeduesve doganor;
- Është vendosur bashkëpunimi me kllasterë të tekstilit;
- Është eliminuar kontrolli i dyfishtë në kalimet kufitare (policia doganore më nuk i mban kamionët për shkak kontrollit të dokumenteve doganore dhe shënimet kantate të cilat i kryejnë nëpunësit doganor);
- Është eliminuar dërgesa e dyfishtë e akcizave transportuese veçmas sepse të njëjtat janë siguruar me garant bankar. Atë tani e bën vetëm Drejtoria e Doganës, ndërsa shqyrtohet mundësia vetëm në fazën e parë dhe Drejtoria e Doganës mos të lëshoj karvan të cilët transportojnë naftë dhe derivate të naftës;
- Po futen burnuse ku është e nevojshme dhe ku mundet, me qëllim për shpejtimin e procedurës doganore;
- Në bashkëpunim me shërbimin doganor të Republikës së Serbisë është kryer matja dhe analiza e saktësisë dhe procedurave në kalimin kufitar Tabanovcë me qëllim identifikimi i mundësive për shpejtimin e procedurave të thjeshta dhe inicimin për përmisimin e bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve doganore. Është bërë marrëveshje për këtë lloj matje që të kryhet në janar të 2007 edhe me Republikën e Greqisë në kalimin kufitar Bogorodicë;
- Në bazë të iniciativës të tekstilit klaster, në rrjedhë janë aktivitetet për ndryshimin e rregullores me qëllim lehtësimin dhe largimin të evidentimit doganor dhe fitimin e lejes, unifikimin dhe thjeshtësimin e mënyrës të udhëhequr të importit të repromaterialeve për prodhime të dedikuara për eksport, kompletimin e raporteve të mbetura dhe jo të mbyllura për eksport të kryer në bazë të importit. Po shqyrtohen mundësit për zvogëlimin e shumës të garantit bankar me të cilat ndërmarrjet japin sigurim Drejtorisë së Doganave se eksporti për importin do të realizohet;
- Janë realizuar kërkesat nga Komisioni Evropian për përfshirjen e RM në sistemin pan euro mediteran të prejardhjes diagonale komulative ;
- Kanë filluar aktivitetet për vendosjen e sistemit elektronik për lidhjen reciproke me NP HM;

- Po shqyrtohen mundësit për eliminimin të sporteve gjatë punës me palët;
 - Po unifikohen procedurat doganore në të gjitha degët doganore, zbatimi i qëllimeve të veçanta, dhe po shqyrtohen mënyrat për vendosjen e afateve për nxjerrjen e akteve nga sfera e punës doganore;
 - Po shqyrtohen mundësitë për aplikimin e personave të vetë rregulluar për licencimin e punëtorëve ekspedues dhe firmave speditimi dhe mënyra e kontrollit;
 - Kanë filluar aktivitetet për përparimin e sistemit të procedurës së thjeshtë doganore, eksporti për fisnikërim dhe eksporti i përkohshëm, udhëzim për borxhin doganor dhe udhëzim për transport, lirim nga procedurat doganore, udhëzim për marrje, udhëzim për vlera doganore;
 - Është përgatitur elaborat për aktivizimin e doganës laboratorike.
4. Ndalimi i importimit jolegal, transit dhe dalje në dhe nga RM të lëndëve narkotike, armëve, letër me vlerë dhe mallra tjerë, lëndë dhe pronësi intelektuale, terrorizëm dhe larja e parave.
- Në suaza të aktiviteteve për luftën kundër krimit të organizuar, ekipi mobil i Drejtorisë së Doganave në territorin e RM për 11 muaj kanë kryer kontroll detale të 700 automjete transportuese, 480 autobus dhe 1250 automjete udhëtimi. Është kryer kontroll plotësues të 94 shoqërive tregtare dhe pronësi lejimi për procedurë me efekt ekonomik (eksport për fisnikëri, depo publike doganore etj.). Si rezultat i këtyre kontrollëve si dhe aktiviteteve tjera është kryer sekuestrim i:
 - 233 kg drogë mariuanë dhe 24.4 kg drogë heroin;
 - 25 milion cigare me vlerë të llogaritur në shumë prej 52,5 milion denarë, me çka lartësia e largimit nga tatimet (dogana, akciza, TVSH) ka kushtuar 86.5 milion denarë;
 - Lloje tjera të mallrave, me çka vlera e mallit të konfiskuar dhe evitimi i të dhënave arrin gjithsej 148.5 milion denar;
 - Valuta (129.605,00 euro, 46.200,00 frang Zvicëran, 120.000,00 dollar Kanadez, dhe 16.036.00 dollar të SHBA, 33 çeka në vlerë prej 182.704,59 euro);
 - Si rezultat të thirrjeve të pranuar anonime në linjën doganore 197 janë zbardhur më shumë kundërvajtje dhe është kryer konfiskim i mallit të cilat janë në lloje të ndryshme (cigare, tekstil, prodhime ushqimore)
 - Kundër kryerësve të veprave penale dhe kundërvajtjeve janë parashtruar gjithsejtë 79 kallëzime penale dhe 997 kundërvajtje penale. Kallëzimet penale kanë të bëjnë për veprat shmangie nga tatimet dhe mashttrim doganor, gjegjësisht për mosplotësimin dhe largimin nga ana e personave fizik dhe juridik të detyrim ligjit për arkëtim të dhënave doganore dhe të dhënave tjera në shumë të përgjithshme prej 287 milion denar. Janë përgatitur 228 propozime për arkëtim plotësues të ma pak për llogaritur dhe borxhi doganor në lartësi prej 11.6 milion denar. Në procedurën administrative janë zbatuar gjithsejtë 5.228 lëndë nga të cilat Drejtoria e Doganës i ka zgjidhur 4.553
 - Me qëllim rritjen dhe efikasitetin në zbardhjen e kriminalitetit ekonomik është rritur bashkëpunimi me MPB, Prokurori Publik dhe policia financiare, ndërsa komunikimi rrjedhë edhe në bazë ditore.
 - Nëpërmjet qendrës SEKI Drejtoria e Doganës ka marr pjesë në përgatitjet, e koordinimit dhe realizimit të operacionit HURIKAN, kundër tregtisë me pulla falsifikuese dhe operacioni KONTEJMENT 5 kundër tregtisë me drogë dhe lëndëve narkotike;

- Në kuadër të misionit KAFAO në RM është vendosur baza për konfiskim dhe po përgatiten analizat e para për profile të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me mallrat akcize. Ka filluar të realizohet projekti për analizë të automjeteve të zbrastë transportuese të cilat lëvizin në territorin e RM, krijimin e veglave analitike për mbushjen AT dhe bashkimin e tyre me AT të zbrastë, projekt për centralizim administrim të dhënave të kalimit kufitar dhe tjera .
- Punohet për përparimin e kapacitetit të nëpunësve doganor për zbulimin dhe largimin e kundërvajtjeve doganore dhe informimin doganor;
- Është ngritur procedura për furnizimin e qenve për kryerjen e hetimeve dhe sigurimin personal dhe resurse tjera (tani janë aktiv vetëm tre qen);
- Ka filluar procedura për furnizimin e skenarëve për kontroll të automjeteve;
- Janë infiltruar raporte javore dhe seri kohore për vëllimin e punëve të kryera nga ana e shërbimit kufitar dhe degëve doganore (automjetet e kontrolluara, zbulimi i kundërvajtjeve doganore dhe vepra penale etj)

Si pjesë nga lufta e gjithë përfshirë të keqpërdorimit të pasurisë intelektuale, përkatësisht mbrojtja e saj, Drejtoria e Doganës i realizoi aktivitetet në vijim,

- Janë regjistruar 43 kërkesa për marrjen e veprave doganore në përputhje me ligjin për masa doganore për mbrojtjen e së drejtës nga pasuria intelektuale;
- Janë zbuluar 45 raste për importim në RM mall i cili e cenoi të drejtën nga pasuria intelektuale ;
- Është prishur malli i cili e cenon të drejtën nga pasuria intelektuale në shumë prej 36.300 copë nga brend të ndryshëm;
- Në tre raste është ngritur procedurë gjyqësore ;
- Është filtruar baza e të dhënave për rastet e shkeljes të së drejtës nga pasuria intelektuale.

5. Në periudhën prej 01.01.2006 deri në 15.12.2006 nëpërmjet Drejtorisë së Doganës janë paguar gjithsejtë 31 miliard denar në emër të dhënave eksportuese, me çka është 9.44% më shumë në raport me tërë vitin 2005. Nga shuma e përgjithshme, 4,8 miliard denar tërë në emër të doganës (16.7 % më shumë në bazë të tërë vitit 2005), 24,9 miliard denar në emër të TVSH (12% më shumë se viti 2005), 0,64 miliard denar në emër të akcizës (26,8% më shumë se viti 2005)

Aktivitetet në Drejtorinë e Doganës deri në fund të këtij viti dhe vitin 2007, në të cilën pritët të ketë efekt dhe mbi rritjen e të ardhurave nga të dhënat eksportuese, kanë para së gjithash karakter strukturor (dhe me çka nuk është e mundurshme kuantifikim në vlerë parash). Ato janë masa për përforcimin e kontrollit në kalimin kufitar, përdorim i mënyrës së drejtë për vërtetimin e prejardhjes, vlera dhe tarifa, si parametra për llogaritjen e borxhit doganor, përforcim i hetimeve (të brendshme dhe të jashtme) dhe masa të drejtuara drejt ndalimit të korrupsionit.

Më saktësisht, masat janë në vijim:

- Zbatimi i patjetërsueshëm i të drejtave për vërtetimin e borxhit doganor (prejardhja e mallit, procedura doganore, vlera, tarifa) me çka rrjedhë :
- ndërrimi dhe plotësimi i urdhëresës për borxhin doganor;
- miratimi i urdhëresës për lirin në procedurë doganore;
- plotësimi i urdhëresës për vlerën doganore;
- Furnizimi me mjete për laboratorin doganore;
- Përmirësimi i të dhënave për analizim gjatë rizikut për vërtetimin e prejardhjes dhe vlerësimin e mallit;
- Përforcimi dhe intensivi i inspektorëve të brendshëm dhe hetimet me qëllim mbikëqyrjen e përkatëse të borxhit doganor të vërtetuar dhe paguar nga ana

- e doganierëve, kontrollin e lidhjes së doganierëve me sektorin privat në bazë të frekuencës të punës reciproke;
- Aksione të koordinuara me DNP për zbulimin e rasteve për kthim të TVSH në bazë faturave për kryerjen e importit të trilluar;
 - Intenzivimi i kërkesave për vërtetim e vlerës së faturës të mallrave importuese (kur është i paqartë çmimi i ulët, me atë edhe themeloria për llogarinë e të dhënave importuese) nga administratat doganore të vendeve nga të cilat përgjithësi i marrim rëndë apo nuk përshtatet informata kthyesë (të përfshirë edhe nëpërmjet MPJ dhe ambasadave)
 - Realizimi i hetimeve të përforcuara për mashtrim në bazë të tregimit të rrejshëm të çmimeve të vogla gjatë eksportit (sepse me atë tregon fitim më të vogël si bazë për llogarinë e tatimit paraprak).
 - Trajnim të punësuarve në sektorin për kontroll dhe hetime në lëmin e kontabilitetit dhe financave.
 - Hyrja në punë e ekipeve mobile.
 - Shitja intensive e mallit të konfiskuar :

6. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në suaza të projektit për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Evropën juglindore (TTFEQ) janë liruara në përdorim kalimi i rindërtuar në Tabanovcë dhe kanë filluar aktivitetet të programit të ri TTFEQ 2, në kornizë të së cilës do të rregullohet kalimi kufitar në Bllacë (për qarkullim të udhëtarëve), dhe do të përmirësohet puna në degët doganore hekurudhore.

Në pjesën e bashkëpunimit ndërkombëtar janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Në organizim të Drejtorisë së Doganës dhe USAID-it u mbajt konferencë regjionale për harmonizimin e kërkesave të dhënave tregtare në Evropën juglindore dhe mundësia për ndryshimin elektronik të të dhënave, në të cilën marrën pjesë përfaqësuesit nga shumë shërbime doganore nga regjioni, institucionet ndërkombëtare dhe sektorët publik dhe privat. Qëllimi i konferencës ishte mundësia e hyrjes të konceptit të sistemit një sportel. (Single Window);
- Është përgatitur memorandum për hyrjen e sistemit special ndërmjet RM dhe R. Kroacisë i cili do të mundëson ndryshim elektronik të të dhënave, me qëllim për pengimin me kohë për kryerësit e kundërvajtjeve doganore;
- Vazhdoj me realizimin programi për ndihmë teknike me Ministrinë e financave të Holandës-Drejtoria e Doganës;
- Në bashkëpunim me shërbimin doganor të Republikës së Francës, janë realizuar seminare nga fusha e hetimeve dhe identifikimin.;
- Ka filluar bashkëpunimi me shërbimin doganor të Italisë për marrjen e softuerit të tyre doganor AIDA me qëllim për ndryshimin e softuerit doganor të RM ASIKUDA.
- Është thëlluar bashkëpunimi me shërbimin doganor të UNMIKUT me formimin e grupeve punuese me qëllim për veprimin operativ në më shumë sfera;
- Po itenzivohet bashkëpunimi me doganën e Serbisë, veçanërisht në pjesën e ndryshimeve elektronike të të dhënave.
- Me shërbimin doganor të Serbisë është realizuar matje të përbashkët të kohës të duhur për procesion e mallit dhe udhëtarëve nga të dy anët të kalimit kufitar. Në përgatitje janë aktivitetet të njëjta me shërbimin doganor të Greqisë;

- Është lidhur marrëveshje për bashkëpunim dhe ndihmë në çështjet doganore midis Qeverisë së Republikës Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës Finlandeze ,dhe e njëjta është lëndë për ratifikim.;
- Në përgatitje është nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim doganor me Republikën Sllovaqe dhe Bosnjes dhe Hercegovinës. Është iniciuar edhe procedurë për lidhjen e kësaj lloji marrëveshjeje për bashkëpunim edhe me Ukrainën;
- Në suaza të aktiviteteve të lidhur me programin nacional për adaptimin e së drejtës të UE,Drejtoria e Doganave në nënkryen 29 të Unionit Doganor, në tërësi i plotëson obligimet nga ky program për vitin 2006.